



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 700/3 prot.

Elbasan, më 17.7.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj nr.58 dt.24.06.2025 “Për krijim servitut kalimi”, si dhe pasi u njohëm me të dhënat sqaruese, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

Për pikën 8 të aktit tuaj, të zbatohen dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA

11. 4585
2.07. 2025

Sek Petaj

01.07.07



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 400/1 prot.

Elbasan, më 27. 2025

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, përpara se të shprehemi për ligjshmërinë e aktit tuaj nr.58 dt.24.06.2025 “Krijim servitut kalimi“, ju bëjmë me dije se lidhur me këtë vendim tuajin ka paraqitur një ankesë z. Pëllumb Alija (bashkëngjitur një kopje), i cili e kundërshton këtë vendim pasi pretendon se vendosja e një porte metalike pengon rrugë kalimin për në banesën e tij. Ankuesi pretendon se për portën që kërkon të vendosë z. Bahiti, Bashkia Librazhd më parë, konkretisht më 21.10. 2021 dhe më 23.8.2024 ka vendosur për heqjen e kësaj porte, vendime të cilat janë ekzekutuar.

Sa më sipër përpara se shprehemi për aktin në fjalë, kërkojmë:

- Të shqyrtohet ankesa dhe pretendimet e z. Pëllumb Alija dhe të na sqaroni pse keni vendimmarrje të ndryshme për të njëjtën problematikë?
- Të na dërgoni një kopje të relacionit të hartuar nga drejtoria përkatëse ku të parashtrohen arsyet për nxjerrjen e aktit, duke argumentuar për problematikat, qëllimet, objektivat që synohen të arrihen, përparësitë, si dhe efektet e pritshme nga miratimi.

Deri në dërgimin e të dhënave akti juaj mbetet i pakonfirmuar.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 700

Dt. 27.6.2025



VENDIM

Datë.26.06.2025

Nr. 462 prot

Nr.58 dt.24.06.2025

“KRIJIM SERVITUT KALIMI”

Ne mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, ‘Per Veteqeverisjen Vendore’, Nenit 54 Per Detyrat dhe Kompetencat e Keshillit Bashkiak, Nenit 265 Kodi Civil dhe kerkeses se Z. Abdyl Bahiti dhe per krijim servitut kalimi ne prone publike, Këshilli Bashkiak I mbledhur sot më date 24.06.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Te krijoje servitut kalimi funksional per kembesore dhe per mjete ne ngarkim te pasurise Nr. 295 (identifikuar me shkronjen A) ne pronesi SHTET ,ne favor te pasurive Nr.3/392 dhe Nr. 3/393 ne pronesi te Z. Abdyl Bahiti dhe Znj. Bukurie Bahiti.
2. Personat qe kane bere kerkese nuk kane dalje ne rrugen publike dhe nuk mund ta sigurojne ate pervec se me shpenzime te medha e me veshtiresi, si dhe krijimi i kesaj rruge kalimi perben rrugen me te shkurter , me me pak deme dhe me me pak shpenzime.
3. Rruga e kalimit mbi te cilin kerkohet servituti e paraqitur edhe ne Plan Rilevimin bashkangjitur ka sherbyer si rruge per palet dikur por tani ka humbur funksionimin e plote dhe te sigurte.
4. Menyre tjeter kalimi per Z. Abdyl Bahiti dhe Znj. Bukurie Bahiti nuk ka;
5. Pershtatja dhe rregullimi i servitutit te kalimit do te kryhet nga personat kerkues Z. Abdyl Bahiti dhe Znj. Bukurie Bahiti.
6. Personat qe kerkojne te drejten e servitutit duhet ta perdorin ate sipas titullit te tij, ne lidhje me cdo gje qe eshte e nevojshme per ta perdorur ate, ne kohen e menyren qe sjell me pak veshtiresi per pronarin e prones sherbyese shtet.
7. Personat qe ushtrojne servitutin kane te drejte te kundershtojne kedo qe e pengon kete te drejte, duke kerkuar sipas rastit rivendosjen e plote te tij, pushimin e cenimit qe i behet si dhe shperblimin e demit te pesuar.
8. Personat qe ushtrojne servitutin kane te drejte te vendosin porte metalike per te garantuar sigurine e prones private.
9. Ndjek zbatimin e ketij vendimi, Kryetari i Bashkise dhe Drejtoria e Kontrollit Planifikimit te Territorit dhe Prones .
10. Ky vendim hyn ne fuqi 10 (dhjete) dite pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Milit BICAKU

